



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr. 28/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, parashtruar kundër subjektit politik GI Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 22.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.28/2025, e datës 20.12.2025, parashtruar nga Subjektit Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër Subjektit Politik GI Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 20.12.2025 në PZAP-i, është parashtruar ankesë nga subjekti Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, në të cilën pretendohet se me datë 19.12.2025, duke shqyrtuar faqen zyrtare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, hasëm në një publikim me titull "Nga fjalët në vepra: Ministria ka dorëzuar subvencione individuale" në linkun <https://mkk.rks-gov.net/al/news/nga-fjala-ne-veper-ministria-ndau-subvencione-individuale>

Parashtruesi i ankesës thekson se i njëjti material është shpërndarë përmes faqes zyrtare në Facebook të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, dhe se në këtë material gjenden fotografi të përfituesve të subvencioneve që Ministria për Komunitete dhe Kthim i ndan qytetarëve. Andaj duke shqyrtuar fotot, mund të konstatohet lehtësisht se në to është i pranishëm këshilltari i ministrit për komunitete dhe kthim, Igor Rašiq, një funksionar i lartë i GI "Za Slobodu, Pravdu i Opstanak", i cili ka qenë kandidat për kryetar komune i këtij subjekti politik, në zyrën zyrtare të ministrisë, duke shpërndarë së bashku me marrëveshjen e

subvencionit edhe material promocional, në formë të fletëvotimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare në një format më të vogël. Parashtruesi i ankesës thekson se me këtë është shkelur Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme 08/L-228, pikërisht neni 4, paragrafi 1, pika 7, i cili thotë: "është rreptësisht e ndaluar përdorimi i zyrave publike, burimeve ose personelit të çdo institucioni në nivel qendror apo vendor për qëllime mbështetjeje të një subjekti politik në zgjedhje", si dhe neni 36 i ligjit të përmendur, i cili thotë: Veprimet e ndaluara të një shërbyesi publik Personi që ushtron një funksion publik, i zgjedhur ose i emëruar, nuk mund ta përdorë atë funksion apo ndonjë aspekt të tij për të fituar vota. Asnjë burim i çdo institucioni të administratës publike, në nivel qendror apo vendor, apo i çdo ndërmarrjeje në pronësi ose nën kontroll të autoriteteve qendrore apo vendore, nuk mund të përdoret apo të vihet në shërbim të mbështetjes së ndonjë subjekti politik në zgjedhje. Asnjë subjekt politik gjatë periudhës së fushatës zgjedhore nuk duhet të inkurajojë ose të përfitojë nga një shërbyes publik duke përdorur pozicionin e tij publik për të kryer fushatë për subjektin politik. Përveç rasteve të parashikuara me ligj, burimet ose mjetet e institucioneve ose organeve publike në nivel qendror apo vendor, apo të çdo lloji tjetër institucioni publik, nuk mund të përdoren ose të vihen në shërbim të mbështetjes së subjekteve politike në zgjedhje.

Më tej parashtruesi i ankesës thekson se me këtë veprim, është shkelur Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe në përputhje me të kërkojnë që PZAP-i, ta pranojë ankesën si të bazuar, që në përputhje me rregulloret të caktojë ndëshkimet përkatëse ndaj subjektit politik GI " Za Slobodu, Pravdu i Opstanak dhe që t'ia kalojë materialet organeve kompetente që të kryejnë procedurën penale përkatëse.

Si dëshmi dhe shtojcë të ankesës kanë dorëzuar fotot në formë të printimeve të ekranit nga sajti dhe faqja e përmendur në Facebook e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim në të cilat pretendohet shkelja.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik GI Za Slobodu, Pravdu i Opstanak thekson si në vijim: Paqartësia dhe pabazueshmeria e pretendimeve për fletëvotimin. Pretendimet se në fotografi shihet një fletëvotim nuk bazohen në fakte të qarta dhe të provueshme. Objekti që ndodhet në duart e fituesit nuk është i dukshëm qartë, fotografia është e vogël dhe nuk lejon identifikimin e asnjë fletëvotimi zyrtar. Në bazë të një materiali të tillë, nuk është e mundur të nxirret një përfundim i besueshëm apo të konfirmohen akuza e paraqitur. Ministria nuk përdor ambientet zyrtare për promovim politik. Theksojmë se Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk i ka përdorur kurrë, as i përdor, ambientet e saj zyrtare për qëllime promovimi të ndonjë subjekti politik. Dhënia e çmimeve është realizuar në përputhje me rregullat, pa asnjë shenjë ose aktivitet politik. Praktikë e njëjtë për të gjithë fituesit. Duke shqyrtuar materialet dhe fotot nga ngjarja, shihet qartë se asnjë nga fituesit e tjerë nuk mban asnjë fletëvotim apo material politik, gjë që konfirmon më tej se nuk ka pasur aktivitet të organizuar apo të qëllimshëm politik brenda kësaj ngjarjeje. Fituesi ka marrë pjesë me iniciativën e tij. Fituesi i çmimit erdhi në organizimin e tij personal, pa ndonjë udhëzim, drejtim apo material të siguruar nga Ministria. Çdo gjë që eventualisht kishte me vete, nuk ishte dhe nuk mund të ishte në organizim ose kontroll të Ministrisë. Kategorikisht hedhim poshtë pretendimet se Ministria ka

lejuar futjen ose shpërndarjen e fletëvotimeve. Një sjellje e tillë nuk do ta lejonim kurrë, dhe të vërtetat në ankesë paraqiten si akuza të paqëndrueshme dhe të pasakta, të drejtuara për diskreditimin e institucionit. Në bazë të të gjithave si më sipër, ne mendojmë se ankesa është e pabazuar, pa prova përkatëse, dhe propozojmë që ajo të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore si dhe përgjigjen në ankese, gjeti se:

- *Ankesa është e pa bazuar*

Paneli me rastin e shikimit dhe analizimit të detajuar të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa nuk është e bazuar pasi që paraqitësi i ankesës nuk ka bashkangjitur provë bindëse në mbështetje të pretendimeve të tij, dhe si e tillë nuk mund të vërtetohet se janë përdorë ambientet zyrtare për promovim politik, nga ana e zyrtarëve të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim respektivisht nga këshilltari i ministrit për komunitete dhe kthim, Igor Rašiq nga subjekti politik GI " Za Slobodu, Pravdu i Opstanak", duke ju ndarë qytetarëve subvencione dhe material promocional, në formë të fletëvotimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare. Me nenin 36 paragrafi 1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, parashihet se *"personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje"*.

Sipas vlerësimit të Panelit nga provat e bashkangjitura nuk ka mundur të vërtetohet shkelja e pretenduar dhe si e tillë nuk ka mundur të argumentohet në mënyrë të qartë dhe bindëse se zyrtar të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim gjegjësisht këshilltari i ministrit për komunitete dhe kthim, Igor Rašiq nga subjekti politik GI " Za Slobodu, Pravdu i Opstanak" duke shfrytëzuar pozitën publike ka bërë fushatë zgjedhore në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, ashtu siç pretendon pala ankuese. Kjo pasi që nga provat e ofruara në formë të fotove dhe nga link-u i paraqitur në ankese nga pala ankuese nuk mund të shihet se është bërë ndonjë thirrje publike për të votuar subjektin politik GI " Za Slobodu, Pravdu i Opstanak apo ndonjë kandidat për deputet nga ky subjekt politik. Nuk ishte kontestuese se në rastin konkret bëhej fjalë për një prezantim të fituesve të projekteve dhe ndarje të subvencioneve por assesi nuk është vërtetuar se ky organizim kishte të bënte me ndonjë aktivitet zgjedhor, andaj nga këto arsye Paneli e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e palës ankuese. Po ashtu paneli nuk ka mundur të vërtetojë pretendimin e palës ankuese se zyrtarët nga kjo ministri respektivisht këshilltari Igor Rašiq të kenë shpërndarë fletëvotime me të cilën e kanë udhëzuar përfituesit e subvencioneve që të votohet GI " Za Slobodu, Pravdu i Opstanak apo ndonjëri nga kandidatet e këtij subjekti.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *"vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla në mungesë të dëshmive të qarta i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë parashtruesi i ankesës nuk ka

arritur që të vërtetohet se ka pasur shkelje të dispozitave të lartcekura të LZP-së apo të Rregullës Zgjedhore nga zyrtarët e subjektit politik GI " Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.28/2025 më datën 22.12.2025

Kryesuese e Panelit,

Kymete Kicaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.